



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:090906 **C. nr. 1010/2020**
Datë: 29.12.2020
Numri i dokumentit: 01379423

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit, KEDS, në Prishtinë, kundër të paditurit A.D., nga Prizreni, Rr. “.....”, p.n., për kompensim dëmi, jashtë seance, me datë 29 Dhjetor 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Miratohet kërkesëpadia e paditëses KEDS, në Prishtinë.

Detyrohet i padituri A.D., nga Prizreni, t’i paguan paditëses KEDS shumën 3.575,02 €, në emër të dëmit të shkaktuar me kamat vjetore 8 %, nga data 03 Gusht 2020 (datë e parashtrimit të paditës) deri në pagesën definitive. Si dhe të paguan shpenzimet e procedurës në shumën 40,00 €, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me padinë e paraqitur kundër të paditurit A.D., nga Prizreni, ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadiës në atë mënyrë që të detyrohet i padituri të paguan shumën 3.575,02 €, në emër të dëmit të shkaktuar.

Në padinë e paraqitur paraqet se me Aktgjykimin P.nr. 599/2019 datë 09.10.2019, i padituri A.D., nga Prizreni, është shpallur fajtor për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 i Kodit Penal të Kosovë.

Sqarojnë që sipas llogaritjes që kanë bërë dhe atë sipas faturës për rikthimin e humbjeve vlera e dëmit që i është shkaktuar paditëses është 3.575,02 €.

Gjykata një kopje të padisë dhe provave të bashkangjitura padisë i ka dorëzuar palës së paditur me vërejtje për dhënien e përgjigjes në padi, duke e udhëzuar palën e paditur që të paraqet përgjigje me shkrim në padinë e palës paditëse. Ndërsa në anën tjetër edhe e ka njoftuar për pasojat e mosveprimit sipas asaj vërejtje.

Pasi që pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi si dhe duke pasur parasysh faktin se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe të njëjtat nuk janë në kundërshtim me provat e administruara, gjykata në kuptim të nenit 150 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që të miraton kërkesëpadinë e palës paditëse.

Gjithashtu bazë për miratimin e kërkesëpadisë, gjykata vlerësoi dëmin të cilin i është shkaktuar palës paditëse me kryerjen e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, si dhe faturës për rikthimin e humbjeve. Ashtu siç përcaktohet edhe me nenin 136 par. 1 lidhur me nenin 169 par. 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Mbi këtë bazë edhe miratoi shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shuma prej 3.575,02 € është reale sipas llogaritjes së bërë për subjektet afariste në kohëzgjatje 12 muaj, e cila është në përputhje me nenin 31 par. 1 dhe 2 të Rregullave për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Gjykata vendosi që pala paditur të paguan kamatën vjetore prej 8 % nga data 03 Gusht 2020, deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke miratuar shumën prej 40,00 € për taksa gjyqësore për padinë e paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 1010/2020 datë 29 Dhjetor 2020

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:090906
Datë: 29.12.2020
Numri i dokumentit: 01379423